



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Integritet Evropian**

**Mbledhja nr. 5**

**Prishtinë, më 30.10.2017, në orën 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla S-225**

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

**Munguan:** Fitore Pacolli dhe Glauk Konjufca.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE, NDI, KDI dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi, znj. Blerta Deliu Kodra, kryetare e komisionit.**

**Kryetarja-Blerta Deliu- Kodra,** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

**Rend i dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja** theksoi se në seancën e 26 tetorit, është vendosur që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar.

Bazuar në vendimin e datës 26 tetor 2017, sot është afati i fundit që, ne si komision kryesor, ta shqyrtojmë dhe të japim rekomandimin.

Andaj, më lejoni që të paraqes opinionin ligjor lidhur me përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Komisioni funksional për këtë projektligj ka paraqitur *raportin me amendamente*.

Sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me buxhetin e shteteve anëtare, këto çështje nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së, por mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare.

Andaj, konstatoj se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk rregullohen me legjislacion të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj, hapi debatin.

**Armend Zemaj**, tha se qëndroj prapa kërkesës sime, që e kam paraqitur në seancë plenare, që të largohet ndarja e 5 milionë €, për pagesën që t'i bëhet nga vendimi i arbitrazhit, mos të jenë pjesë e ndarjes buxhetore për këtë vit, pa u kryer procedurat ligjore në Republikën e Kosovës, sipas Ligjit për arbitrazhin dhe këtë e kam theksuar edhe në seancë plenare. Pra, nuk e paragjykoj vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit, por dëshiroj që procedurat ligjore të vendit tim, të plotësohen tërësisht, për t'u bërë një pagesë e tillë, derisa ne kemi dy konflikte ligjore të papërfunduara, njëra në Gjykatën Themelore në Kosovë dhe pjesa tjetër që i takon Ministrisë së Drejtësisë, po ashtu e ka atakuar këtë vendim dhe ne nuk kemi një raport se ku kanë shkuar, andaj edhe sot po e theksoj se është e panevojshme dhe e paarsyeshme që të bëhet pagesa, pa u kryer këto dy procedura ligjore dhe jam kundër këtyre amendamenteve, si dhe do të jem kundër edhe në seancë plenare, nëse nuk ka një tërheqje të tillë.

**Kryetarja** hodhi në votim Projektligjin me raportin me amendamente dhe pas votimit, me 6 vota për, 1 votë kundër dhe një abstenim, nxori këtë:

## **Rekomandim**

Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, me amendamentet e Komisionit funksional, me konstatimin se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, pasi që këto çështje nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së, por mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare.

### **3. Të ndryshme**

**Kryetarja**, lidhur me këtë pikë, pyeti anëtarët nëse duan ta marrin fjalën.

**Ilir Deda**, theksoi se komisioni, në një nga mbledhjet e kaluara, pati marrë vendim që pas 22 tetorit, pas zgjedhjeve, ta caktojë datën se kur do ta ftojë në komision, kryesuesin e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të Kosovës me Malin e Zi, z. Shpejtim Bulliqi.

**Kryetarja** njoftoi anëtarët se për të martën është ftuar për raportim në komision, ministrja e Integritetit Evropian, znj. Dhurata Hoxha, andaj propozoi që pas raportimit të saj, të ftohet z. Bulliqi.

Nga anëtarët kishte propozime që të ftohet të hënën, andaj kryetarja e hodhi ne votim.

**Kryetarja**, në fund, konstatoi se komisioni, njëzëri u pajtua që të hënën, më 6 nëntor, në orën 11:00, të ftohet në komision për raportim, z. Shpejtim Bulliqi, kryesues i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të Kosovës me Malin e Zi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e komisionit.**

**Kryetare e komisionit,**

-----

**Znj. Blerta Deliu-Kodra**